



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Zenel Hisenaj	Data e autorizimit të ekspertit 30.08.2022	Data e dorëzimit të raportit 09.09.2022	Nr. i lëndës: 377 /22
---------------	---	--	--------------------------

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 23.08.2022, “Botek shpk” -, Prishtinë ka parashtruar ankesë me nr: 377/22, kundër propozimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me pjesë dhe pajisje elektronike për IT” me nr. të prokurimit: 214-22-4598-1—1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosovës – PRISHTINË.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 473 338,00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE ---“Botek shpk”

Hyrje

Përmes kësaj Ankese, ne kundërshtojmë Vendimin e AK për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim (KpR) të pranuar me datë 16.08.2022. Ne vijim po e elaborojmë edhe një herë në detaje jo vetëm pretendimet tona por do të jemi të detyruar të shpërfaqim kontradiktat e theksuara në mes të; Kërkesës për Sqarimeve të Tenderit (KpST), Vendimit për Tenderuesin e Eliminuar si dhe Vendimin mbi refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim.

Lot/Pjesa 1 Referencë;

**Pjesa 1, Artikulli 4.**

AK e ka bazuar eliminimin e ofertës sonë në një lëshim teknik tonin i cili ka rrjedhë gjatë bartjes së specifikimeve teknike të Artikullit 4 ku është shënuar specifikimi teknik i pajisjes nga Artikulli 5 dhe anasjelltas, mirëpo **emri dhe modeli i pajisjeve** të ofertuara është i saktë dhe i duhuri tek të dyja pozicionet.

Pra, bëhet fjalë për lëshim të cilin edhe AK gjatë vlerësimit e ka konstatuar dhe një lëshim i tillë përmes

sqarimeve të tenderit do të mund të qartësohej, duke mos ndryshuar asgjë në material dhe çmim..

Ne nuk po e mohojmë faktin që në këtë rast specifikimin teknik për pozicioni 4 është bartur gabimisht tek pozicioni 5 dhe anasjelltas përshkrimi teknik i pozicionit 5 është bartur tek pozicioni 4.

1. Mirëpo, AK gjithashtu është dashur të konstatoj se emri dhe modelet e pajisjeve të ofertuara për të dyja pozicionet kanë qenë të sakta dhe të njëjtën kanë pasur mundësi ti verifikojnë në Broshurat e dorëzuara me tender, pavarësisht faktit se përshkrimi teknik nuk është vendosur tek pozicionet përkatëse 4 & 5, ku për secilin pozicion janë dorëzuar Broshurat përkatëse me emërtimet: **4. Poz 4 IDEAL 2245 CC dhe 5. Poz 5 IDELA 2604 CC.**

2. Për më tepër, në dokumentin shtesë të dorëzuar bashkë me tenderin **“8. Deklarata mbi specifikimin teknik dhe deklaratat tjera”**, përveç emrit të pajisjeve dhe prodhuesit edhe Specifikimi teknik është i plotë dhe i vendosur saktë tek secili pozicion (4&5) ashtu sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit dhe aty nuk ka pas asnjë lëshim teknik.

Kjo deklaratë si e tillë e detajuar është pjesë e ofertës sonë dhe e njëjta është 100% e plotësuar dhe i përmbushë kërkesat sipas dosjes së tenderit dhe rrjedhimisht do të duhej të merrej parasysh gjatë vlerësimit të tenderit.

Duke pas parasysh faktin se ky dokument është i kërkuar në Dosjen e tenderit (pika 3.1 e FDT-së), kërkesë që duhet të plotësohet nga ana e OE dhe si i tillë do të duhet patjetër të merret për bazë gjatë vlerësimit nga ana e Komisionit Vlerësues që AK nuk e ka bërë dhe me këtë rast ka shkel LPP

**Prova 1:** Dokumenti i dorëzuar me tender; **“8. Deklarata mbi specifikimin teknik dhe deklaratat e tjera”**

Përfundimisht, në Vendimin e AK për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim përkundër sqarimeve të dhëna nga ne në Kërkesë për Rishqyrtim dhe Fakteve/ Dokumenteve të dorëzuara me tender e të cilat provojnë përtej çfarëdo dileme se pajisjet e ofertuar nga ne për LOT 1 i plotësojnë 100% të gjitha kërkesat nga Dosja e Tenderit dhe se oferta jonë financiare është rreth 20% nën buxhetin e planifikuar nga AK dhe rrjedhimisht sipas LPP oferta jonë do duhej të vlerësohej e përgjegjshme.

Lot/Pjesa 3

**Referencë, Pjesa 3. Artikulli 2. IIYAMA ProLite LH 5552UHS-B1**

Konstatimi i AK në **“Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar”**, nuk është i bazuar në asnjë Nen të LPP dhe RRUOPP, dhe se përkundër sqarimeve të tenderit me çka ishte sqaruar gjithçka nga oferta jonë, AK sërish ishte thirrur në konstatime të pabazuara në asnjë fakt të vetëm.

Së pari, sqarimi i tenderit sipas LPP bëhet pikërisht për të qartësuar ofertën e dorëzuar nga OE me tender e ku bëjnë pjesë ofertat teknike/financiare, dokumentet tjera si dhe Broshurat e dorëzuara me tender, pa ndryshuar në material apo çmim.

Ne si OE pas kërkesë së AK për sqarimin e tenderit me datë 02.08.2022, kemi dërguar të gjitha sqarimet shtesë të nevojshme edhe për sa i përket pyetjes se AK-së që lidhet me *Matrix Support*, të cilin si detaj nuk kanë mundur t'a gjejnë të shënuar në Broshurën e prodhuesit të dërguar me tender.

Ndër të tjerash në sqarimet tona të dërguara, në lidhje me këtë pozicion, ne kemi cekur se pajisja e ofertuar i plotëson 100% kërkesat nga dosja e tenderit dhe se njëra nga karakteristikat e këtij Produkti është përkrahja e teknologjisë Matrix (VA Matrix); dhe kemi dërguar këte link te produktit te ofertuar per verifikim: <https://iiyama.com/gl/en/products/prolite-lh5552uhs-b1/>

Pra kemi derguar link nga web faqja e prodhuesit per kete produkt dhe JO katalog tjetër.

Pika 39 të RRUOPP-së, e cila qartëson saktë se: “39.3 Megjithatë, lejohet qe një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkoj dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë ne aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, ne mënyre objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës se publikimit të Njoftimit për kontrate.”

Në Vendimin e AK është keqinterpretuar përgjigja jonë që ne kemi dorëzuar me datë 03.08.2022. Pavarësisht faktit se në përgjigjen tonë ne kemi dërguar mjaftueshëm prova, sikurse na kërkon/lejon edhe LPP/RRUOPP, ku mund të verifikohet pika që ka ngrit AK dhe se pajisja ka edhe suportin e teknologjisë Matrix, por në asnjë mënyrë nuk kemi theksuar se ekziston në **një tjetër katalog** (sikurse AK ka pretenduar në vendimin e saj te Letra Standarde per tenderuesi e eliminua ).

Ndërsa tani te Vendimi mbi Refuzimin e Kërkeses per Rishqyrtim, te përgjigja e AK në Pretendimin 2, per këtë pozicion, shihet qart se edhe AK konsaton se artikulli 2 posedon teknologjine VA Matrix. Pra ndryshon mendimin për këtë pikë, mirëpo në mënyrë për të na eliminuar AK, shkojnë përtej kërkesave të DT dhe tani arsyetojnë eliminimin duke thene se eshte kerkuar Matrix Support (HDMI Matrix).

Çuditërisht AK ne Vendimin për Refuzimin e tenderit tani më NUK i referohet MATRIX Support sikurse ne Kërkesën për Sqarime të tenderit dhe shpjegimeve të dhëna, por tani në vendimin per Refuzim të KpR, shkruajnë për **HDMI Matrix** dhe interpretojnë si kërkesë e që ne fakt nëse i referohemi DT kjo NUK ka qenë fare ne Dosjen e Tenderit por as në Kërkesa për Sqarimin e Tenderi të dërguar nga ana e AK me date 02.08.2022.

Përkundër faktit se AK gjatë eliminimit paraqet kërkesa shtesë vetëm me tendecë për të eliminuar ofertën tonë, vlen edhe fakti se as AK nuk e ka te qartë përdorimin e HDMI Matrix dhe e perdore vetem sa per te gjetur arsye per eliminimin e ofertes tone. Ne Pergjigjen e tyre ata permendin funksionimi e shume TV/monitor si nje ekran i madh dhe njekohesi cekin pa pasur nevoj te lidhjes mes vete te ketyre TV-ve. Nese nuk do te lidhen ne mes vetes keta TV ateherë si do te funksionojne si nje ekran i madh?!

**Sqarim Plotësues Teknik ne pretendimin e Ri të AK:** Arsyetimi dhe shpjegimi i AK ne lidhje me “Matrix support”, kur ata shkruajnë tani për “HDMI Matrix”, që pra nuk ka qenë kështu e formuluar në tender si e tillë, pikërisht me një ndryshim të tillë të kërkesave të tenderit ne ketë fazë të vlerësimit AK një “një ndryshim i tillë i kërkesë/arsyetim është duke bërë ndryshimin material dhe ndryshim të kërkesave të tenderit gjatë vlerësimit”.

Tutje, po e qartësojmë sërish në aspektin teknikisht / profesional edhe këtë pretendim dhe përpjekje të AK për ta eliminua ofertën tonë në kundërshtim me DT, Sqarimet shtesë dhe rrjedhimisht me LPP.

Me këtë rast po e Ri-konfirmojm se pajisja ofertuar nga ne: **IYAMA ProLite LH 5552UHS-B1** posedon HDMI dhe kjo pajisja profesionale apo cilado pajisje e ngjashme e kategorisë profesionale e cila posedon një Port HDMI mundëson të jetë pjesë e një Matrice të 2 apo me shumë TV/ Monitorëve- Vidowall nese nderlidhen me HDMI Matrix..

Pra, vetëm porti HDMI dhe kablloja HDMI nuk ka asnjë funksion tjetër ne vetvete tek një TV, përveç se transmetimit të sinjalit të video dhe audio. P.S: Një zgjidhje për VideoWall e kompletuar me të gjitha pajisjet e nevojshme për funksionim është e kërkuar pikërisht në këtë LOT3 si dhe e ofertuar nge ne, pozicioni 1 i këtij Loti.

Dhe nese i analizojme kerkesat per Pozi.1 te ketij Lot3, i cili do te perdoret per VideoWall, aty nuk kerkohet asnje support per "HDMI Matrix", mirepo kjo nuk do me thene se TV e ofertuar nga ne Nuk mund te perdoret per VideoWall.

Ndersa Poz.2 i cili edhe eshte teme e kesaj ankese, AK kane kerkuar "TV Industrial" dhe as qe permendet shfrytezimi i VideoWall, por gjithsesi kjo pajisje profesionale e ofertuar nga ne mund te integrohet ne ndonje projekt si VidoeWall dhe se te njejtin fakt e kemi sqarua ne Pergjigjet tona per Sqarimin e Tenderit.

Pra AK jo vetem se po ndryshon kriteret e tenderit gjate procesit te vleresimit por ka lajuar dhe jane leshuar edhe ne konstatime teknike / profesionale te paqendrueshme, per te mos thene tendencioze.

LOT/Pjesa 4

#### **Referencë: Pjesa 4. Artikulli 1.**

Pretendimet E AK në "Letrën standarde për tenderuesin e eliminuara", për Pjesën 4, Artikulli 1. jo vetëm se NUK janë të bazuara në asnjë Nen të LPP apo RRUOPP, por mund të cilësohen si tendencioze.

Në përgjigjet/sqarimet dt. 03.08.2022, të dërguara nga ne e kemi ri-konfirmuar se produkti i ofertuar nga ne me tenderin; ACELab PC 3000 Portable III i plotëson 100% të gjitha kërkesat nga dosja e tenderit dhe cilido pretendim ndryshe mund të kualifikohet si shtrembërim i qëllimshëm i fakteve.

AK me gjas qëllimisht ka injorua dhe po injoron krejtësisht përgjigjet tona në kërkesën e tyre për sqarim të tenderit, ku ne përtej çfarëdo dileme teknike dhe profesionale, duke u mbështet edhe në konfirmimin shtesë nga vetë prodhuesi ACELab, me dt.03.08.2022, ua kemi ri-konfirmuar se **"pajisja e ofertuar nga ne përmbush plotësisht kërkesën tuaj nga dosja e tenderit dhe se me këtë rast e kemi Ri-konfirmuar se Pajisja e ofertuar Supporton edhe HDD: 500 MB - 8 TB: 3.5", 2.5", 1.8", 1.0"**.

Për më tepër, ne shprehim habi se si AK nuk ka marrë për bazë fare ofertën tonë teknike (Dokumenti i dorëzuar me tender; **"8. Deklarata mbi specifikimin teknike dhe deklaratat tjera"**) ku saktësisht shkruan se pajisja e ofertuar suporton HDD 500 MB - 8 TB: 3.5", 2.5", 1.8", 1.0", si dhe sqarimet tona të cilat i kemi të ri-konfirmuara direkt nga vet prodhuesi ACELab:

a). When we talk about supported models we mean a full support of the HDD in Technologic Mode, that's why there is no such information on our web site. - PC-3000 Portable III can handle with any size HDD based on PATA interface in case of a logic issues. - SATA-based drives supported without capacity limitation in both modes - Logical and Physical issues Shënim: Për të vërtetuar këtë, me kërkesën tuaj, ne mund t'ua dërgojmë konfirmimet që kemi pranuar nga prodhuesi, apo ju mund të kontaktoni direkt prodhuesin ACELab për çfarëdo pyetje që ju mund të kenë: Sofia Izotova- Sales Representative. Web: [www.acelab.eu.com](http://www.acelab.eu.com) ; Email: [sales2@acelab.eu.com](mailto:sales2@acelab.eu.com) ; Tel: +420 212 277277; Skype: Sofia ACE Lab.

Pretendimi i AK si në vijim se "në specifikacion të pajisjes së ofertuar mungon një pjesë e specifikimit teknik" dhe se ne përmes sqarimeve të dhëna në kërkesën për sqarimin e tenderit në asnjë rrethanë, **nuk kemi bërë asnjë ndryshim material** pasi që me përgjigjet e dhëna nuk kemi ndryshuar asgjë nga oferta jonë teknike.

Ne në të gjitha përgjigjet tona gjithmonë i jemi referuar produktit të ofertuar **"ACELab PC 3000 Portable III"**, dhe vetëm kemi sqaruar dhe ri-konfirmuar se pavarësisht ndonjë lëshimi / lapsusi në shkrim në njërin nga dokumentet e dorëzuar, ne me tender kemi dorëzuar edhe ofertën tonë teknike të detajuar të cilën e gjeni ne dokumentin **"8. Deklarata mbi specifikimin teknike dhe deklaratat e tjera"**, ku është e përfshirë edhe kjo

pjesë e vogël e tekstit të munguar e specifikimit teknik dhe ka qenë pjesë integrale e ofertës sonë.

Pra, ne sërish Ri-konfirmojmë se në deklaratën tonë mbi specifikimin teknik kemi specifikuar në tërësi saktësisht modelin e pajisjes si dhe prodhuesin **“ACELab PC 3000 Portable III”** dhe në këtë deklaratë janë përfshirë të gjitha specifikimet teknike ashtu sikurse është kërkuar në dosjen e tenderit.

**Prova 1.** Dokumenti i dorëzuar me tender; **“8. Deklarata mbi specifikimin teknik”**

**Prova 2.** **“Përgjigje në Kërkesën për Sqarimin e Tenderit”** dërguar me 03.08.2022.

Pretendimi i AK se tek **Pjesa 4 Artikulli 1.** ne **“si OE edhe përkundër sqarimeve të tenderit si OE nuk paskemi ofruar dëshmi se në katalogun /broshurën e prodhuesit që e ka këtë mundësi dhe se mungon **“(number of active Licences 2X – to install the software on both a desktop computer and a laptop)”**, është jashtëzakonisht jo profesional dhe tendencioz.**

**Sqarim shtesë:** Ashtu sikurse e kemi sqaruar edhe përmes përgjigjeve tona për sqarimin e tenderit, në Broshurën e prodhuesit nuk mund të paracaktohet numri i licencave pasi që numri i licencave ndryshon varësisht nga kërkesa e klientit brenda projektit, prandaj edhe AK nuk ka pas mundësi të gjej në broshurën e dorëzuar me tenderin dhe nuk ka kuptim as të kërkohej kjo kërkesë aty.

Mirëpo Numri i Licencave (2 Licenca) është i përcaktuar saktësisht në ofertën tone teknike të dorëzuar bashkë me tenderin dhe njëkohësisht e ri-konfirmuar nga ne si dhe edhe nga vetë prodhuesi, konfirmime këto të dërguara në Përgjigjet tona për sqarimin e tenderit.

Pra, edhe njëherë po ri-përsërisim dhe qartësojmë se ne së bashku me tenderin kemi dorëzuar ofertën tonë teknike (dok. **“8. Deklarata mbi specifikimin teknik dhe deklaratat e tjera”**) ku është e precizuar saktësisht numrin e Licencave **(number of active Licences 2X – to install the software on both a desktop computer and a laptop)** 100% ashtu sikurse kërkohej në dosjen e tenderit.

**Prova 1.** Dokumenti i dorëzuar me tender; **“8. Deklarata mbi specifikimin teknik dhe deklaratat e tjera**

**Prova 2.** **“Përgjigje në Kërkesën për Sqarimin e Tenderit”** dërguar me 03.08.2022.

Duke u bazuar në Dokumentet e dërguara së bashku me Tender si dhe Provat; **“8. Deklarata mbi specifikimin teknik dhe deklaratat e tjera”** dhe **“Përgjigje në Kërkesën për Sqarimin e Tenderit dërguar”** konsiderojmë se oferta e jonë përmbushë 100% kërkesat tuaja nga dosja e tenderit dhe rrjedhimisht do duhet të konsiderohej e përgjegjshme.

Prandaj, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i Prokurimit që t'i merr për bazë të gjitha Provat e bashkangjitura si dhe Sqarimet e dhëna nga ana jonë në Kërkesën për Sqarimin e Tenderit dhe se Kërkesën për Rishqyrtim dhe të merr një vendim meritore:

- Të anulohet **“Njoftimi mbi Vendimi e AK”** si dhe
- Lënda të kthehet në **Ri-vlerësim**.

**Pretendimet ankimore të parashtruara në ankesën e deponuar në OSHP, janë të njëjta.**

## KRITERET PËR VLERËSIM

### III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

- a) Deklarata nën betim se operatori ekonomik përmbushë kërkesat mbi përshtatshmërinë nën 65 të Ligjit nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin. No. 05 L-092, do të dorëzohen në formë të Aneksit 2.
- b) Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës
- c) Vërtetimin nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike- Një dokument të lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbushë “Kërkesat e përshtatshmerise” së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës
- d) Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme

- a) Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.
- b) Vërtetim nga Administrata Tatimore
- c) Vërtetim nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike - origjinal kopje e noterizuar
- d) Vërtetimin nga Gjykata Themelore – origjinal kopje e noterizuar

Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen nga ofertuesi fitues, përpara publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor, që do të thotë se ofertuesi do të refuzohet, do të humbasë garancinë e sigurisë së ofertës dhe Autoriteti Kontraktues do të vazhdojë tenderuesin e listuar në vendin e dytë.

### III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

- |  |   |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik- Çertifikata Regjistrimit të Biznesit (nëse OE i jashtëm shpallet fitues duhet të regjistroj përfaqësinë në Kosovë para nënshkrimit të kontratës)</li> <li>b) Certifikata e TVSH-se (për Operatoret Ekonomik vendor)</li> <li>c) Certifikata me Numër Fiskal (për Operatoret Ekonomik vendor)</li> <li>d) Për pjesën 4 Autorizim nga prodhuesi distributorit të autorizuar të prodhuesit për shitjen e produkteve që ofroni për tenderin me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Çertifikata e Regjistrimit të Biznesit e lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (kopje)</li> <li>b) Certifikatën e TVSH-së (kopje) (për Operatoret Ekonomik vendor)</li> <li>c) Numri Fiskal i lëshuar ( Kopje ) (për Operatoret Ekonomik vendor)</li> <li>d) Për pjesën 4 Autorizim nga prodhuesi distributorit të autorizuar të prodhuesit për shitjen e produkteve që ofroni për tenderin me titull dhe nr. Prokurimit të projektit në fjalë</li> </ul> |
|--|---|

### III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

- |   |  |
|---|--|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK-së, se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë në vlerë, se bashku në të tri vitet, prej jo më pak se<br/>Pjesa 1 160,000.00 Euro,<br/>Pjesa 2 150,000.00 Euro,<br/>Pjesa 3 140,000.00 Euro,<br/>Pjesa 4 60,000.00 Euro.</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>a) OE duhet të dëshmojë me deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit.</li> </ul> |
|---|--|

### III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

- |  |   |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Për pjesën 4 OE duhet të ofrojë ngrancion nga prodhuesi distributorit të autorizuar të prodhuesit minimum 3 vite.</li> <li>b) OE për Pjesët 1, 2, 3 dhe 4 duhet të dorëzojë katalog broshurë me karakteristika teknike të prodhuesit në detaje me të cilën është e mundur vlerësimi i specifikave teknike të ofruara.</li> <li>c) Deklarata për specifika teknike mbi përmbushjen e specifikave teknike sipas pikës 3.1 të FTD-së</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>a) Për pjesën 4 OE duhet të ofrojë ngrancion nga prodhuesi distributorit të autorizuar të prodhuesit minimum 3 vite</li> <li>b) OE për Pjesët 1, 2, 3 dhe 4 duhet të dorëzojë Katalog broshurë me detajet e nevojshme për vlerësim, me selektim ose nënvizim në mënyrë të qartë për secilin artikull.</li> <li>c) Deklaratë e vulosur dhe nënshkruar nga OE mbi përmbushjen e specifikave teknike sipas pikës 3.1 të FTD-së</li> </ul> |
|--|---|



## RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

### DEKLARATË

Komisioni i Vlerësimit të Tenderit, pas vlerësimit dhe ekzaminimit të tenderit konstaton se nuk kemi ofertues të përgjegjshëm.  
Komisioni i vlerësimit të Tenderit rekomandon që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në mungesë të një oferte të përgjegjshme.

### PROCESVERBALI PËR EKZAMINIMIN, VLERËSIMIN DHE KRAHASIMIN E TENDERËVE

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshatshmëritë administrative:

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshatshmëritë teknike:

1.	NTP Online 600196241	<p>OE ka deshtuar në:</p> <p>Ne DT është kërkuar specifikisht:</p> <p>"Ne kolonën e dytë të shënohet emri i plote i pajisjes (Lloji/Modeli me të cilën aplikohet) dhe po ashtu të bëhet përshkrimi i specifikave obligative."</p> <p>Pjesa 3, Artikulli 1: Hisense 49" 4WUHD Digital Signage nuk e ka të specifikuar Active Display, e që është kërkuar të posedojt njëjtin;</p> <p>Pjesa 3, Artikulli 2: IYYAMA Prolite LH 5552UHS-B1 është kërkuar të ketë Matrix Support e që nuk e ka në specifikacionet e ofruara si dhe mungojnë në katalog.</p>
2.	QUATRO TRADE SH.P.K. 811034610	<p>OE ka deshtuar në:</p> <p>Ne DT është kërkuar specifikisht:</p> <p>"Ne kolonën e dytë të shënohet emri i plote i pajisjes (Lloji/Modeli me të cilën aplikohet) dhe po ashtu të bëhet përshkrimi i specifikave obligative."</p> <p>Ne pjesën 1 ka deshtuar</p> <p>OE ka deshtuar të i sjellë Specifikacionet Teknike për artikujt 3,4,5,6 (pjesërisht),9,10 dhe 11</p> <p>Andaj është i papërgjegjshëm</p>
3.	IoT Smart & Green SH.P.K. 811493866	<p>OE ka deshtuar në:</p> <p>Ne DT është kërkuar specifikisht:</p> <p>"Ne kolonën e dytë të shënohet emri i plote i pajisjes (Lloji/Modeli me të cilën aplikohet) dhe po ashtu të bëhet përshkrimi i specifikave obligative."</p> <p>Ne pjesën 1 ka deshtuar</p> <p>OE ka deshtuar të i sjellë Specifikacionet Teknike nuk e ka plotësuar sipas kërkesë në DT</p> <p>Gjithashtu në mesin e dokumenteve në ofertën e OE-se gjendet edhe një dokument (MAF) i lëshuar nga Schneider Electric.</p>

B36 Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve- procedura e hapur"



		Buġgħaria EOOD per kompanin QUATRO TRADE SH.P.K.e cila është gjithashtu pjesëmarrëse në këtë aktivitet i prokurimit.
		Andaj i është i përgjegjshëm
4.	Botek shpk 600151328	<p>OE ka deshtuar me:</p> <p>Ne DT është kërkuar specifikisht:</p> <p>"Ne kolonën e dytë të shënohet emri i plotë i pajisjes (Lloji/Modeli me të cilën aplikohet) dhe po ashtu të bëhet përshkrimi i specifikave obligative."</p> <p>OE ka ofertuar për pjesët 1,3, dhe 4</p> <p>Ne pjesën 1 ka deshtuar:</p> <p>Artikulli 4 Shredder 1</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>* min. 7 sheets per pass / 100 sheets per day</li> <li>- 27 sheets per pass / 2500+ sheets per day</li> <li>- Shreds paper, staples, paperclips, CDs/ DVDs &amp; Credit Cards</li> <li>- 4X40mm cross cut / DIN security level P-4 for sensitive, confidential &amp; personal data</li> <li>- 310 mm Entry Throat (A4 &amp; A3)</li> <li>- Bin Capacity: 1500 sheets - 120 litres</li> <li>- Dimensions (WxDxH): 538 x 470 x 930 mm</li> <li>- Machine warranty: 1 year</li> <li>- Cutter warranty: lifetime</li> </ul> <p>Artikulli 5 Shredder 2</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>* 27 sheets per pass / 2500+ sheets per day</li> </ul> <p>OE ka ofertuar me Shredder 1 IDEAL 2604</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 7 sheets per pass/100 sheets per day</li> <li>- Shreds paper, staples &amp; paperclips</li> <li>- 3x25mm cross cut / DIN security level P-4 for sensitive, confidential &amp; personal data</li> <li>- 220mm entry throat (A4)</li> <li>- Bin capacity: 280 sheets - 20 litres</li> <li>- Dimensions (WxDxH): 345 x 213 x 428 mm</li> </ul>

B36 Formulati standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve- procedura e hapur

7

		<ul style="list-style-type: none"> <li>- Machine warranty: 1 year</li> <li>- Cutter warranty: lifetime</li> </ul> <p>Andaj shpallet i përgjegjshëm për Pjesën 1</p> <p>Ne pjesën 3 ka deshtuar:</p> <p>"Ne kolonën e dytë të shënohet emri i plotë i pajisjes (Lloji/Modeli me të cilën aplikohet) dhe po ashtu të bëhet përshkrimi i specifikave obligative."</p> <p>Pjesa 3 Artikulli 2: IYYAMA Profile LH 5552UH5-B1 është kërkuar të ketë Matrix Support e që nuk e ka në katalog;</p> <p>Ku edhe vete kompania me sqarimet e dates 02.08.2022 e pranon që nuk është e specifikuar në katalogun e ofruar bashkë me oferte financiare, duke na udhëzuar që egziston në një tjetër katalog andaj çdo ndryshim tjetër konsiderohet ndryshim material.</p> <p>Ne pjesën 4 ka deshtuar:</p> <p>"Ne kolonën e dytë të shënohet emri i plotë i pajisjes (Lloji/Modeli me të cilën aplikohet) dhe po ashtu të bëhet përshkrimi i specifikave obligative."</p> <p>Pjesa 4 Artikulli 1 është kërkuar Supported HDD: 500MB - 8TB: 3.5", 2.5", 1.8", 1.0", kurse OE ka ofertuar ACELab PC-3000 Portable III me Supported HDD. Do të thotë që në broshurë egziston vetëm 40 GB - e më shumë por jo me pakë. Katalogu i ofruar edhe pse sqarimeve nuk i përmbush kërkesat, Aneksi 1 dhe FIT</p> <p>Pjesa 4, Artikulli 1: në specifikacion të pajisjes së ofruar ACELab PC-3000 Portable III mungon pjesa e Spec Teknike e kërkuar "Supported interfaces: mSATA - via a special SATA - mSATA adapter from ACE Lab which can be bought optional Micro SATA, PATA, LIF, ZIF, Apple proprietary interface - via additional adapters from third-party vendors".</p> <p>Kemi kërkuar sqarim me date 02.08.2022 dhe kompania vete pranon që ka gabuar, e quan "lapsus" mungesën e një pjesë të Specifikacioneve teknike në kolonën ku është kërkuar si obligative.</p> <p>Pjesa 4, Artikulli 1: Mungon "number of active licenses: 2 (to install the software on both a desktop computer and a laptop)" e cila është kërkuar në Specifikacione Teknike.</p> <p>OE nuk ka ofruar dëshmi në katalogun/ broshurën e prodhuesit që e ka këtë mundësi, ku edhe vete e pranon në sqarimin e dates 02.08.2022</p> <p>Andaj konsiderohet e përgjegjshme</p>
--	--	--

B36 Formulati standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve- procedura e hapur

8

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga "Botek shpk" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pjesë dhe pajisje elektronike për IT", me numër të prokurimit: 214-22-4598-1 - 1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Policia e Kosovës - PRISHTINË

## PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES “Botek shpk”

### Përgjigje ne pretendimin Ankimor 1.

Bazuar ne dosjen e tenderit, Raportin e Vlerësimit si dhe dokumenteve te Ofertës se OE Ankuese për procedurën: “Furnizim me pjesë dhe pajisje elektronike për IT” Paraqes këtë Konstatim

Referuar kërkesës se AK-se dosjes se Tenderit te njëjtit si pjese se dosjes se Tenderit paraqesin kriterin nen kategorinë e **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:**

OE për Pjesët 1, 2, 3 dhe 4 duhet te dorëzojë Katalog broshure me detajet e nevojshme për vlerësim, me selektim ose nënvizim në mënyrë të qarte për secilin artikull.

Referuar Specifikave teknike te Kërkuara nga AK te njëjtit paraqesin këtë kërkesë:

SPECIFIKIMET TEKNIKE SIPAS DOSJES SE TENDERIT	
4	<b>Shredder 1</b> * min. 7sheets per pass /100 sheets per day * Shreds Paper, Staples & Paperclips * 3x25mm Cross Cut / DIN Security Level P-4 for sensitive, confidential & personal data. * 220mm Entry Throat (A4) * Bin Capacity: 200 sheets - 20 litres * Dimensions (WxDxH):345x213x428mm Machine Warranty: 1year Cutter Warranty: Lifetime
5	<b>Shredder 2</b> *27 sheets per pass / 2500+ sheets per day *Shreds Paper, Staples, Paperclips, CDs/DVDs & Credit Cards *4x40mm Cross Cut / DIN Security Level P-4 for sensitive, confidential & personal data. *310mm Entry Throat (A4 & A3) * Bin Capacity: 1500 sheets - 120 litres *Dimensions (WxDxH): 538x470x930mm *Machine Warranty: 1year *Cutter Warranty: Lifetime
<b>OFERTA E OE ANKUESE</b>	

<b>4</b>	<b>Shredder 1</b>	<b>IDEAL 2245 CC</b>
	27 sheets per pass / 2500+ sheets per day	27 sheets per pass / 2500+ sheets per day
	Shreds Paper, Staples, Paperclips, CDs/DVDs & Credit Cards	Shreds Paper, Staples, Paperclips, CDs/DVDs & Credit Cards
	4x40mm Cross Cut / DIN Security Level P-4 for sensitive, confidential & personal data.	4x40mm Cross Cut / DIN Security Level P-4 for sensitive, confidential & personal data
	310mm Entry Throat (A4 & A3)	310mm Entry Throat (A4 & A3)
	Bin Capacity: 1500 sheets - 120 litres	Bin Capacity: 1500 sheets - 120 litres

**Botek** « Rruga „Agim Ramadani“ nr. 517, 10000 Prishtinë, Kosovë

tel: +383 (0)38 24 58 30 / 40 ; fax: +383 (0)38 24 56 25 ; e-mail: info@bo-tek.com ; web: www.bo-tek.com

3      Titulli:      "Furnizim me pjese dhe pajisje elektronike për IT"  
Ref.:      214-22-4598-1-1-1

**BOTEK**

	Dimensions (WxDxH): 538x470x930mm	Dimensions (WxDxH): 538x470x930mm
	Machine Warranty: 1year	Machine Warranty: 1year
	Cutter Warranty: Lifetime	Cutter Warranty: Lifetime
<b>5</b>	<b>Shredder 1</b>	<b>IDEAL 2604 CC</b>
	min. 7sheets per pass /100 sheets per day	7sheets per pass /100 sheets per day
	Shreds Paper, Staples & Paperclips	Shreds Paper, Staples & Paperclips
	3x25mm Cross Cut / DIN Security Level P-4 for sensitive, confidential & personal data.	3x25mm Cross Cut / DIN Security Level P-4 for sensitive, confidential & personal data.
	220mm Entry Throat (A4)	220mm Entry Throat (A4)
	Bin Capacity: 200 sheets - 20 litres	Bin Capacity: 200 sheets - 20 litres
	Dimensions (WxDxH):345x213x428mm	Dimensions (WxDxH):345x213x428mm
	Machine Warranty: 1year	Machine Warranty: 1year
	Cutter Warranty: Lifetime	Cutter Warranty: Lifetime

Bazuar ne dokumentet e ofertës se OE-se ne fjale e njëjta ka ofruar edhe këto dokumente për këtë procedure:

1. Katalog broshure me detaje:

# IDEAL 2245

Innovative, compact deskside shredder  
with EASY-Touch for intuitive operation



22 cm

Level P-2 4 mm strip cut


Sheet capacity\*: 11-13 @ 9-11

Level P-4 1 x 25 mm particle cut

Sheet capacity\*: 6-7 @ 5-6

Level P-5 2 x 15 mm particle cut

Sheet capacity\*: 4-5 @ 3-4



\* At paper 70 gsm / 80 lb

## Technical specifications

Volume 20 litres (shred bin)

Power 230 V / 50 Hz\*\*

Motor capacity 150 Watt single phase motor

\*\* See voltage and Hz



Dimensions 428 x 345 x 213 mm (H x W x D)

Weight 4.5 kg / 7.5 kg (particle cut)

## Product characteristics

Easy-to-use deskside shredder for environmentally conscious users. EASY-Touch multifunction switch element for stand-by / stop / off / reverse with integrated optical signals for the operational status of the shredder. Photo cell controlled automatic start and stop. Automatic reverse and power cut-off, ZERO ENERGY standby mode: complete, automatic disconnection from power supply after 15 minutes. Transparent safety flap in the feed opening as additional safety element. Quiet, powerful and energy-efficient single phase motor. Double motor protection. High-quality, paper clip proof cutting shafts from special hardened steel with lifetime guarantee. Attractive shred bin from impact-resistant plastic. Practical handle for lifting off the shredder unit from the bin. Magnetic switch for automatic stop if the shredder unit is removed from the shred bin (2245 CC).

# IDEAL 2604

Powerful document shredder for centralised office use with electronic capacity control, suitable for continuous operation. All shred sizes available.



← 26 cm →

**Level P-2** 4 mm strip cut

Sheet capacity\*: 20-32 / 26-28

**Level P-4** 12 x 14 x 40 mm particle cut

Sheet capacity\*: 20-25 / 21-23

**Level P-5** 2 x 15 mm particle cut

Sheet capacity\*: 15-17 / 13-15


**Level P-6** 0.8 x 12 mm micro cut

Sheet capacity\*: 3-10 / 3-8

**Level P-7** 0.8 x 5 mm super micro cut


Sheet capacity\*: 2-7 / 1-6

\* 75 paper 150 gsm, 150 gsm



## Technical specifications

<b>Volume</b>	125 litres (cabinet) 160 litres (shred bin)
<b>Power</b>	220 v / 50 Hz**
<b>Motor capacity</b>	640 Watt single phase motor ** depending on model



<b>Dimensions</b>	926 x 495 x 470 mm (H x W x D)
<b>Weight</b>	48 kg

## Product characteristics

